

URDHËR
Nr. 352, datë 29.5.2020

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR.326, DATË 15.5.2020 “PËR KUFIZIMIN E
AKTIVITETEVE SPORTIVE”**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 326, datë 15.5.2020 “Për kufizimin e aktiviteteve sportive”, bëhet shtesa si vijon:

1. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtje:

“2/1. Lejohet kampionati i futbollit, pa spektatorë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 1.6.2020.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu